

NIBLEDHJA E 28

(MBLEDHJA E PERBASHKËT TË SENATIT E TË DHOMËS
SË DEPUTETVËT)

(Kryeson: Kryetari i Senatit Z. Eshref Frasher)

E Premte, me 17 Korrik 1925, or 4 pas dreke

Këndohen emnat e ZZ. Senatorvet, dhe munguen: ZZ. A. Dibra, Hafiz Xhemali, S. Vrioni, Shuk Sereqi e Shefqet Vërlaci.

Këndohen emnat e ZZ. Deputetvet, dhe munguen: ZZ. Ahmet Hastopalli Bahri Begolli, Banush Hamdi, Hiqmet Delvina, H. Vrioni, Kosturi, L. Llogori, Mito Tutulani, Q. Durmishi, Q. Vrioni, S. Popa e Stavro Stavri.

Z. KRYETARI : Shumica asht mbledhja hapet.

Zotërinj ! Si pas vendimit qi dhatë Zotërija e Juaj Komisioni i P. të Jashtme i dy Dhomavet u mlohd, dhe preqatiti raportin të cilin e paraqiti. Raportin po e këndoymë, dhe si relator i Komisionit u shenue Zoti Xhemil Dino.

Këndohet rapporti i Komisionit të P. të Jashtme të dy Dhomavet, si pason :

„Tiranë, me 17 Korrik 1925.

Së Naltës Kryesi t' Asemblese Legjislative,

Tiranë.

Komisjonet e Punëvet të Jashtme
të Senatit dhe të Dhoms së Deputet-

vet u mlohdhen sot nen Kryesin e Shkelqësis së Tij Z. Eshref Frasherit, dhe mbassi u konstatue numri ligjuër vendosen t'u paraqesin Asemblese Legjislative raportin qi vijon mbi çesh-tjet e kufivet edhe të varuna midis Republikës Shqiptare edhe Mbretënis Jugosllave.

Duke qenë se Qeverija Shqiptare mbas këshillavet dyherë të përsrituna të Konferencës Ambashadorvet u ndodh përpara disa proponimeve të Qeveris Jugosllave për çak i perket Shen Naunit dhe nji pjesës të Velo-pojes në regjonet e Vermoshit.

Duke qenë se Qeverija Shqiptare me formen e duhur mhas Statutit ju sjellë Asemble Legjislative për ketë çeshtje, mbas vendimit të kësajë të fundit, komisjoni përkatëce studjuenë veçanërisht e hímtesisht proponimet e bamuna prej Qeveris Jugosllave duke marrë dhe informatat e hollësinat e nevojshme prej Shkel. së Tij Z. Meh-di Frasherit, Delegat Shqiptar pranë Komisionit ndër Aleat të kufivet dhe prej ku merret vesht se kufini i zonës të Shnaunit atje ku përfshinte gjithë

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVE

thë gropen e vallatës të Çeravës, d. m. th. Shnaun fusha Pishkupija edhe Lubanishta deri në kodren me naltësin 1005 meter në bregë të likenit, Konferanca e Ambashatorëvet e caktoj vjen e kufirit 750 metro vetem n' orjent të Monastirit në fjalë dhe vazhdoj lumen e Çoravës gjérë afer Halarupit të kodra me naltësi 1055 dhe që andejemi të naltësija 2085, me ketë kufi Peshkupje, Lubanishta, Fusha e Shnaunit si edhe shumica e Valatës Çeravës i mbeten Jugosllavis.

Me ketë kufi gjithë mirësinat ekonomike dhe strategjike për Shqipnis kan renë krejtë. Me afërimin e kufrit karshi portës së Shnaunit edhe si-gurimi i Priftërinjet mbeten në dyshim.

Me qenë se Qeverija Jugosllave Monastirit të Shnaunit i jepë nji rendësi fetare, morale dhe jo ma-pakë prestigji kombtar, proponon qì ky Monastir deri te kodra më naltë 961 t'i lihet asajë e karshi kasajë t' i japë Shqipnis katundin Peshkopi i cili përmban 60 familje thjeshtë Shqip'are e të gjithë anen e sipërme të Valatës Ceravës me posesjonin e të cilës si-gurohet mpiojja e rrugës së Korçë, Pogradec e Elbasan në favor të Shqipnis. Me nji fjalë kërkohet ndertesa e Shnaunit me nji tokë fare te voglë e karshi ksajë i jepet Shqipnis kater herë ma tepër tokë, 300 fymë Shqiptar e sigurim për rrugen Korçë-Elbasan.

Për ç' ka i përket zonës së Vermoshit Qeverija Jugosllave heqë dorë nga të gjithë pretendimet qì kish pa-

së mbajtun deri tash mbi te me përjashtim të nji pjesës së vogel të nji pylli, ne perendim të Velopojes.

Karshi kësajë i jepë Shqipnis nji bjeshkë tjeter midis Lipovices edhe majë e Bejesës deri ne Lubraja ; gjithashtu len liri të plotë për shfrytimin e tokave dhe të bjeshkëve qì kan Shqiptarët përtëj kufinin; me në fund na jepë drejten qì katundet Shqiptar qì ndodhen afer Gjakovës Prizendi e Dibrës të tregëtojnë lirisht pa pague kur farë taksit doganuer në pazaret e këtyre qyteteve, nji avantazje si e shofim mjaft i mathë për në.

Tue qenë se në tokat e kërkue me nga ana Qeveris Jugosllave nuk ndodhet asnii banues edhe asnji godinë veç se nji Monastiri.

Tue pamë se këto vise të kontestueme qysh prej luftës Balkanike e tehu, rreshtas 12 vjet ndodhen n' okupacion të Jugosllavis,

Me qenë se sbrazja e këtyre viseve edhe dorëzimi i tyne të Qeveris Shqiptare mbas situates politike e diplomateke të Balkanit sot duket fort e largtë.

Tue konsiderue se vaxhdimi i mos përfundimit të çeshtjevet të kufive kri-jon situatë të ligë për në jo vetem nga pikpamja morale por edhe uga ptkëpamja materiale pse na ngarkon me shpenzime të mëdhaja.

Tue marrë parasyesh se nga ana tjetër këjo situatë e dyshimshme vonoj gjithë marrëveshtjet okonomike qì kemi nevojë të madhe të bajmë me Jugosllavin për të miren e Shqipnis,

BISEDIMET E DHOMESE SE DEPUTETVE

posaçërisht rregullimi i ujnavet në gjithë zonen e Shkodrës i cili deri tash mbeti vetem e vetem kështu nga shkaku e mosmarrëveshtjeve në dy pikat e kufinit.

Tue pa se përfaqësoj sit e Shtetevet të mëdha shumë herë i kan rakomandue Qeveris veçanërisht nji marrëveshtje në ketë kuptjm d. m. th. në bazen e kompansasjonevet.

Tue marrë parasyesh se n' istorin politikë të shumë Shtetevet gjinden mjaft shembulla më rendësi si tregim lëshimi i Savojës djep'i derës Mbretnore t' Italis si edhe Nizza Atdheu i Garibaldi-t qì u dkanë Francës prej Italis, gjithashtu edhe Isola e Heligolandit qì Imperatorija Dritanike i patë lëshue 2 vjet ma parë Gjermanis, ma së fund nji mot e gjysë përparrë lëshimi i Fiumës prej Jugosllavis në favor t' Italis etj.

Të dy komisjonet pra me ndergjegje të plotë janë të mendjes qì Asembleja të pranoj proponimet e shkembimit q'i beri Qeverija Shqiptare për Monastirin e Sh. Nuanit dhe të nji pjesës të pyllit të Velopojes në bazat q'u panë ma naltë dhe kështu Asembleja Legjislativë t'i japë Qeveris autorizim të plotë të traktojnë çeshtjen definitivisht si çë lypë int.resa e Shtetit,

Kryetari i dy Komisjonave:

Eshref Srasher i d. v.

ZANA : Të japë shpjegime Delegati i Qeveris ...

Z. M. FRASHERI : Shpjegimet i kemi dhanë për veç në kjoftë ndokush

qi ka të bajnë me pyetje at-herë napim shpjegime.

Z. VOKOPOLA : Z. Kryetar zz. Senator e Deputet ! Sot kemi parasyesh nji çeshtje forti me rendësi q'i parashtrohet mbledhjes s' Asemblese në nji kohë të shkurtë kur pakë ma përparrë kemi mbyllë Asemblënë Konstituente të cilën neve qì ishim këtu e kemi mbyllun me dyer trokitje se kombit e Shtetit i fali Statutin. Prapë për nji nevojë të madhe të mbrendshme këjo godinë na përbledhë për t' i dhanë fund çeshtjes së kufinit të myavrun midis Shtetit t' onë e Shtetit Jugosllav mbi Vermoshin e Monastirin e Sh. Naunit. Zotërinj ! Në këto minuts kaqë delikate e kaqë me rendësi nuk është mundur qì në ketë Dhomë përfaqësuesit e këtij kombit të mos thonë sa fjalë ndonse këto fjalë do të jenë në deç t' idhura në deç t'amelta.

Rendësia e Monastirit të Sh. Naunit asht e ditur prej të gjithë popullit Shqiptar, asht e ditur prej ç'do katundarit se kemi bërë sa metinge dhe kemi kërkus qì ky vend istorik mos të ndahet nga gjiri i Atdheut t' onë.

Edhe prej nesh ndodhen shumë qì në gjinë e kësajë godinë edhe nepër metinge kemi mbajtun fjalë e kemi kërkue prej pushteteve të mëdha qì të na përbushet deshira e jonë. Asht e vertet Zotërinj, se kur do herë politika nuk e përbush deshiren e nji populli se ajo nuk ka mëshirë, po asht edhe e vertet se kur fati, nji kombë të vogel e detyron të marrë nji vend-

L'IS EDIMET E DHOMES SE DEPUTETVE

4im kundra deshirës të tij, se nuk asht e mundun që na mos të tregojmë idhërimin t' onë.

Dje edhe sot mbledhjet që u banë, na dhanë të kuptojmë se neve sot jemi mbledhun për t'i dhanë fund çeshtjeve të mvaruna kaqë vjet të kufinit t' onë n'anën e Jugosllavis, do të bisedojmë e do të vendojmë përfundisht mbi ato copa të tokave t'ona, d. m. th. mbi një pjesë të Vermoshit si edhe mbi Monastirin e Sh. Naunit. Un Z. Kryetar, me gjithë raportin e dalun nga komisjoni i përbashët, due të kuptoj ma parpara nga Z. M. Frasheri i cili asht Delegat në Komisionin e kufivet, drejë për drejtë istorin qyshk ngajtun deri sot. E kam thanun edhe sot në mengjes se veç fjalve që kemi ndique në mbledhjen e fsheftë, duhet që këto fjalë dhe arësyet t'i ndigjoj i gjithë populli shqiptar, i madhi e i vogli dhe të të kuptoj seicili pse Dhoma e Asembleësë Legjislative dha një vendim të tillë. Pra, pikat që duhen të dihen duhen të thohen çiltas dhe prandaj i lutem si Qeveris ashtu Delegatit të na jepin shkoqitjet e nevojshme, dhe deri at-herë Z. Kryetar e reservoj fjalen t'ime.

Z. MEHDI FRASHERI Deleg. i Qeveris) Z. Kryetar, e zotrinj! Në bisedimet e mëshefta që janë mbajtë, Z. Ministri i P. të Jashtme si edhe neve shpjegimet e duhuna i dhame. Z. F. Vokopola në konviksion të opinionit publik lyp që të jepen edhe një herë shpjegimet e dhanuna. Mua më duket se Përfaqesuesit e popullit duhet të

marrin gjith responsabilitetin e duhur dhe të tilla deklaráta tu shti në mes opinionin publik më duket se janë demagogjira. Se populli ashtë si një cilimi të cilin mund t'a bajsh të qajë ose të qeshi me pakë fjalë; me gjith ketë mbasi populli Shqiptaë asht Patriot dhe deshiron të marrë vesht çdo gjë edhe neve po thomi ato gjena që lypesen.

Si e dini qe Shqiperija u krijua mbas luftes Balkanike, atëherë Shtetet e Mdhaja për të mos dhenë shkak që kjo lufte të generalizohet pranuan krijimin e një Shqiperis, po kufite e saj në u benë ethnike gjografike, e u parapelqyen vijat e kufinit t' oportunitetit të politikës së pergjithshme. Mbashi sandej per shkak të tijera ngjau luftha e përgjithshme, ku Shqiperija hyri përsëri në rezik. Punimi dhe sakrifici i shqiptarëve, ndihma e cirkonstanca-vet solli konferencen e Paqës në një shkalle që të pranoj rish formimin e Shqipëris me kufit 1913 posë disa ndryshimeve që i dinë të gjithë. Për ç' ka i përket zonës Shen Naumit Konferanca e 1913 thotë kësijoj:

Vija e kufinit tue kalue nga Qafa e Thanës afer katundit Lin zbritë në Liqen t' Ohris dhe s' andejmë vete deri në Shen Naum.

Kjo fjalë deri në Shen Naum asht një gje që mund të jepet interpretimi si të duash. Neve si Delegati Shqipnis, dhe Qeverija, natyrisht e kishim për detyrë të mbrojmë interesat e Shtetit, dhe kësaj fjalë deri në Shen Naum i dham kuptimin që Shen Naum

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTEVET

mi i takoa Shqipnis. Qeverija Jugosllave natyrisht mbrojte dhe ajo tezin e vet duke pretendue Shen Naumin. Tashqi o ishte e drejta ionë ose fati na favorizoj, Komisioni pranoj që Shen Naumi të i metesh Shqipnis, ky vendim u dha anë princip që he vajti në Konferencen Ambasadoriale dhe u pranua prej Këshillë Ambasoriale përsëri (en princip) d. m. th. pa u caktuar vija definiteve.

Jugosllavët si e pane qe humë Shen Naumin benë perpjekjet e tyne dhe deshen që vendimin t'a ndrrojnë në ketë arrallek Komisioni i kufivet vajti persëri në Shen Naum për të caktuar vijen, atçherë persëri pranoi të zen t' onë dhe adoptoj vijen deri ne Mamalcn Bullgar, që kësisoj zona e Shen Naumit perfshinte Peshkopen, Lubonishten, edhe gjith basen e Cërvavës me gjith fushën e Shen Naumit. Por ky vendim i komisionit kur shkoj në Këshillen Ambasoriale përsëri kjo tue marrë para sysh tekstin e 1913 nuk vertetoj proponimin e komisionit edhe caktimin e vijes e la për më tutje, veç kësaj disa nga Fuqit e Mëdha tue studjue tekstin e 1913, rane në dyshim dhe per Monastirin e Shen Naumit.

Disa prej atyne tokave pretenduan që dhanja e Shen Naunit Shqipnis en princip ashte një gabim. Një raga fuqit e Mëdha insistoj për vendimin që qe dhanë en princip.

Me qenë se vendimet e Konferences Ambasadoriale lypset t'epen a l'unanimite për të larguar disakordin

në mes të tyre çeshtjen e vendimit en princip është i drejtë a po jo përtë dhënë një vendim të pa anëhem ja hodhi Lidhjes se Kombevet.

Lidhja e Kombevet tha se kjo ashte një çeshje Juridike dhe lypset të veje në Gjykatore e Lahajes.

Gjykatoren dha vendimin në favorin t'one edhe ky vendim ju kthye Lidhjes se Kombevet; kjo vendimin ja paraqiti Konferences Ambasadoriale, e cila u shtrengue që të rish pranoj vendimin e saj, të caktoj dhe vijen definitive, por para se të caktoj vijen u rekumandoj Qeverive t'enteresume një marreveshtje miqsore. Marreveshtja nuk mujti me u bë midis dy Qeverive, atëhere Konferanca u shërengua të caktoje dhe vijen definitive por përfat të keq nuk u pranua vija që kishim kerkuar në dhe që kish aprovar komisioni i kufive. Konferanca pranoj vij-kufin një vijë e cila shkon përpara portes se Monastirit 750 metra, me ketë, menyrë katundet që thame me siper Fusha dhe shumica e Vales Ceraves i mbetet Jugosllavis; Me këtë kufi të çale zona e Shen Naumit humbi gjith rendesin që meritonte perpjekje; veç kësaj fonte komisionin që të shtynte Delegat e shteteve t'interesuem në një marrëveshtje. Neve si Delegat nuk kishim kompetencë të hyjme në marreveshtje se zgjidhja e kësaj çeshtje i takonte Qeveris, dhe neve i treguam Qeveris se si ishte puna. Atëherë Qeverija e jonë hyni në bisedim me Qeverin Jugosllave mbasi edhe Shtetet e Mdhaj

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

që na kanë favorizuam na kanë komandue se do të jetë ma mirë që kjo çeshje të zgjidhet mëqesishët në mes dy Qeverive, se është veme në për dyert e Këshilles Ambasadoriale.

Ketë Këshillë na i dha edhe lidhja e Kombevet. Qeverija pyeti mendimin t' onë, dhe na mendimin e dhame pa rezerve, se nji njeri që pranon një detyre lypset të marri mbi vete dhe responsabilitetin. Burrat e Shtetit duhet të mendojnë thellesisht si është me mirrë për dobi të popullit edhe të Shtetit dhe menuimin e vet a çfaqi pa frike e pa ndrojje Neve i thame Qeveris që nuk sho fjm i do nji enkovenient që Qeverija të hyje në mariëveshtje drejt përdrejt me Shtetin fqinj, dhe i thame që Qeverija në vend të Shën Naumit të marrë Peshkopen që atje kemi nji pjesë të popullit Shqiptar, dhe si kur ay katund të mbetet jashte ata shqiptare do të humbasin kombesin e tyre. Në ketë katund banojnë afer 60 familje shqiptare dhe ky vend ashte kater here ma i madh se çë është pjesa e Shen Naunit; veç kësaj tue pasë na Peshkopen sigurojmë dhe rrugen Korçë, Pogradec, Elbasan, me të cilin katund përfshihet edhe ana e siperme e Valates të Ceraves. Këtu kemi kater fitime dhe inkonvenienti ashte humbja e kater murave të Monastirit të Shen Naunit. Këtu me duket se nuk po sakrifikojmë gja përkundrazi kemi nji avantazh. Si kur t'ishte se Shen Naumi të na ishte dhanë n'at vijn e kufive që kishjm kerkue në atëhere doemos do

të kishte pasë nji rändesi, po ashtu si e ka caktue Konferenca Ambasadoriale nuk kemi ndo nji dobi.

Tani vim tu Vermoshi. Bota pa deh se neve humbim Vermoshin; kjo zotrinj nuk ashte e vertete, se Vermoshi na mbetet neve, Vermoshi përbetet prej kater Valatave prej Shkrapa Tushes, Vuçipotok Lamrajes e Vëlopojes. Nji pjesë e kësaj Valate d. m. th. anen e prendimit të Volopojs i japim Jugosllavis, pse atje janë disa pyje të Kuçit dhe ne për kërrakolle do të ngjajnë kurdohere mos marrëveshtje. Karshi kësaj pjesë Jugosllavit na jepin neve këshesina të tjera. Midis lehtesinave që na jep Jugosllavia ashte tregtija e lirë në Jakovë e në Diber pa pasaport e pa taks doganuer. Pastaj len të lirë ato që kanë toka në kufi me i punue me marrë prodhimin e tokës se tyre, Na Jugosllavis i kemi kerkue nji copë bjeshkë që ndodhet në mes të Bajces e të Llobives që ashtë proprieteti i Bajrakut të Vuklit. Un Qeveris mejtimin t' em ja kam thanë, tashë Parliamenti e Senati të bajnë çka të duan. Tashti zotrinj kjo ashtë në duar t'uej në daçi e pranoni, në daçi jo, dhe seicili duhet të japi vendim me konsiance. Si të doni punoni.

Z. M. LIBOHOVA (Zav. i Min, J.). Zoterinj! Me duket se Z. Delegati gabimisht tha se Qeverija ka dhanë nji vendim për shkembimin e Sh. Naumit me Peshkopen. Qeverija Zoterinj nuk ka dhanë ndonji vendim, dhe çështjen i u a paraqet Zotnis S' uej për ve-

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVE

ndim. Në asht se Zoterinja e Juaj pranoni që të bahet një shkembim, atëherë Qeverija do të hyejnë në marrë veshje dhe kuer t'i mbushet mendja që shkembimi asht për dobi të popullit e të Shtetit, e nuk i bje dam si moral ashtu material do të hyen në pazarlek, për ndryshe Qeverija nuk ban një shkembim.

Bravo.

Z. M. KASSO: Zoterinj! Per sa në e shpjegoi Qeverija e Z. Delegati i jone që kemi në komisionin e kufivet si me dyer të mylluna ashtu më dyer të hapta kuptionet që dobija e jone eshtë të pranojmë një shkembim. Kuër të marrim një vendim të tillë, neve jemi sigur se doemos do të shikojmë si asht ma mirë për Shtet e popull, që bes min që populli na ka dhanë, do t'a mbajmë e do t'i ruejmë interesat e tija. Në vendimin që do të jepim Zoterinj, nuk duhet të menjtonemi si egoist, po përkundrazi duhet të mejtojmë si asht interesa e popullit e Shtetit. Në vendimin që do t'ë jepim lypset të mos veshtromë se do të disaprohet populli apo se q' do të na thotë ky, se populli rri larg këtyre çështjet e cilat na i ka lanë në dorë neve që jemi përfaqesuesit e tij. Zoterinj! Unë përpjekja t'ime me ndergjegje të plote, pas shpjegimevet që na u dhanë dje e sot, tue e marrë mbi vete responsabilitetin i rekomandoi Qeveris të mirret vesh me ata që asht nevoje, dhe t'i jepin instrukcionet e duhuna delegatit t' onë Z. Mehdi Frasherit, i cili me duket i ka

mprojtur shumë mirë të drejtat t'ona, që çështjes se kufivet të mvarun midis Shtetit t'ën e Jugosllavis t'i epet një perfundim sa ma shpejt.

Per ketë çështje kam formulue një vendim, të cilin asht nevoje t'a marrin Dy Dhomat: Sot, tue u mbledhuan së bashku Dy Dhomat, të cilat përbajnë pushtetin legjislativ, si ndigjue ne me dyer të mylluna shpjegimet, arësyet, si dhe mendimin e Z. Ministrit të P. të Jashtme e të Z. Mehdi Frasherit, delegatit t'ën pranë Komisionit të Kufivet, për çështjet e mvaruna të kufinit shqiptaro-jugosllav, dhe si ndigjoj raportin e paraqitun prej Komisionit mixt të Dy Dhomave, autorizoi Qeverin për t'i dhanë kësaj çështje një perfundim sa ma shpejt si pas nevojavet e interesave të Shtetit, t'i jepin delegatit në fjalë. Z. Mehdi Frasherit instrukjonet e duhura përketë çështje,

Zgjdhja e kësaj çështje asht me të vertet një idhërim për neve si Shqiptar por asht edhe një idhërim vëçanerisht për në Ortodokës se humbim Monastirin e Sh. Naumit. Në shumë Shtete Qeverit kan ardhë në një pozitë të keqe të pranojmë me një herë gjera që nuk i do populli. Çështja e e Sh. Naumit më kujton çështjen e Mollal-kut që Konferenca e Berlinit, si në Konferenca e Ambashatorëvet Sh. Naumin, ja kish dhanë Greqis. Qeverit e asajë kohë nuk qje e mundor t'a merrin ketë vend, po humen edhe të tjera që si erdhi në fuqi nii Komoduro e morë Qeverin në

BISEDIMET E DHOMESE SE DEPUTETVE.

dorë i dha fund kësajë çeshtjes e pranoj ma pakë se epte Konferenca e Berlinit. Asht e vertet sek kur ky erdhë të mire autorizimin nga Dhoma e Deputetve, at-herë janë gjindun shumë njerëz të cilët kan kërkue t'a dergoj në gjvqë të natë, dhe at-herë Komoduro ka thanë; si për të miren e Shtetit qì pranova ja e qì pranova, ashtu edhe për të miren e Shtetit vete në Gjyq, dhe tha se populli dikur do të ngrehë S'atuen. Dhe me të vertet nuk shkoj shumë kohë dhe populli i Greqis sherbimet q'i kishte bë At-deut i a njosti. Qeverija ndofta ka frigë me marrë nji vendim të tillë, po neve lypet t'i japim korajo e mos të vesh rojmuç që thotë populli, po të marrim responsabilitetin për sipër dhe t'a fautorizojmë Qeverin, kësajë çeshtje t'i japim përfundim si e do nevoja e interesit i Shtetit, nji orë e ma parë.

Z. M. LIBOHÖVA: (Zav. M. i Jashtme) Qeverija qì asht ne fuqì nuk ka asnjë frigë në detyren e sajë. Ketë fjalë ja këthej Z. së Tij.

Z. K. MIEDA: Z. Kryetar, zz. Senator e Deputet! Sa për çeshtjen e Sh. Naumit Z. Delegati i Shqipnis pranë Komisjonit të Kufivet na dha shpjegime të shkoqituna, të cilat, unë sa për hesapin t'imi, i quej të mjafta-

Tue e njoft burnin e bujarin e fqinjt t'onë, dishroj të japë nji mend në hesap të kesajë çeshtje nji grimëma të gjatë. Z. Ministri i P. të Jashtme me fiale qì na tha na dha nji freski, na tha të na autorizoni me në

pazarlleqe, e na do të punojmë si asht ma mirë për Shtet e popull, e sikur u banë këtu fjalët koton. Vermoshi a Velo poja për hesap t' em ka nji rendësi shumë të madhe, dhe mbaasi këtu flitet për shkembim tokash, lutem qì me fjalen shkembim të hyen Hoti, Gruda e Trepshi. Po t'i epen këto vende Shqipnís at-herë hinterlandi Shkodrës do të smadhohet dhe Shkodra me ketë mënyrë do të gjejnë nji kollajlek për me jetue. Me duket se hajo nuk asht nji gjë e madhe, dhe lus të dy Dhomat t'a autorizoj Qeverin të bajnë nji shkembim të tillë, se sa për pjesat qì përmendë Z. Delegati i jonë nga Jugosllavija sì shkembim, un për hesap t' em jam i mendimit, si me to si pa to.

Z. N. KIÇI: Prej raportit të komisionit të dy Dhomavet q'i u këndue këtu u kuptue se po të bajmë nji shkembim kësosojt do të kemi shumë kollajleqe pse po na u çilkan rrugat, se tregu do të jetë i lirë, se nuk do të na marrë takse Doganore, takse pasaportash etj. Këto gjana mue nuk më gëzojn aspak se po na janë si nji trup pë kamb e pa duerë. Vermoshi Zotërinj, për Malëci t' ona ka nji rendësi të veçantë dhe për to d. m. th. humbja e fikja. U lutem Z. s' Uej të mendoni pak se ç' po hjekun Malcinat t' ona qysh prej vjetes 913. Gadi 100 shpí prej Kelmenjt, Nikëqit e Vuklit kan vaië m' atë anë e po dalin për ditë pse s' kan jetesen. Nuk asht kollaj Zotërinj me denue nji njeri për vdekje para se të vdesin d'he

BISEDIMET E DHOMES SE DEPUTETVE.

prandaj u lutem shumë ketë çeshtje t'a lamë për në vjeshtë.

Z. S. BLLOSHMI: Z. Kryetar! Si e dinë të gjithë shokët e ndershem të kesaj Asemble, i vorfeni populli Shqiptar lirin e vet e ka fitue me mundim të vet, kur se Shtetet fqi lirin e tyre e kan fitue me mprojtene Shteteve të mëdhaj. Kur Serbija ka marrë lirin e vet ka gjet mprojtje plotë te Rusija; gjith ashtu Rumenija. Greqin e Bulgarin e kan mprojt krejt fuqit e mëdha, dhe të mjerin popull Shqiptar, qì kurdoherë asht mundue përlirin e vet i kan vue shkopin para, dhe sikur t'ishte për Projten e të tjerve populli Shqiptar nuk do t'a kishte lirin e tij. Të flasim pak mbi istorin e këtij populli.

Në 1878 kur ishte okupacioni i Turqis e Konferenca e Berlinit kishte da qì disa toka të Shqipnis t'u epe-shin të tjerve dhe Tyrqi po i epte at-herë nji Abdul Frasher mori iniciativen e formoj ligen istorike të Prezendentit ku Shqiptarët vendosne t'i mbajnë tokat e tyne. Ai qì kishte sundimin në dorë dergoi Dervish Pa-shen qì t'i shkelte e t'i lëshojnë, po Shqiptarët prap e mbajten lirin e tyne. Ardhi lufta balkanike, dhe kujtoj qì edhe neve si pjestarët e nji pjesës t' Europes, e jo si aziatikë, do të na u njifshin të drejtat t'ona, po mjerisht prap na u shkelen, po shqiptarët me fuqit e veta e ruejten lirin. Ismail Qemali, tue pasë për rreth vedi mjaft trima Atdhetar, ngriti flamurin e Shqiperis. Në 1920, kur mbaroi lu-

fia e përgjithshme, sado qì nuk kishim marrë pjesë, shum gjak kje derdhë në favor të fuqivet aleatë, p. sh. batailioni i Korçes mori pjesë në fitimin glorios të Fuqivet Aleate, po mjerisht të drejtat e Shqiptarëvet nuk u muren para syshtë. Aso kohe njaj Kryetar qì sot po kryeson ketë mbledhje Z. Eshref Frasher bashkë me Kryetarin e Republikës Z. Ahmet Zogun formuen kongresin e Lushnjës dhe e shpetuen prap Shqipnin. Ambicjonet e intrigat e disavet e shtinë Shtetin në rrezik, po vullndeti i fortë i ketyre njerzvet e i popullit shqiptar e shpetoi prap Atdhen e dashun. Sot prap po na hapet nji çeshtje me randsi, deri sot ishte fjala me marr, e sot po na duhet me lanë. Dalë të shofim njihere, u lypet me lanë apo me ndrue; E drejta e jonë ka humbë ç'me kohë e jo sot, edhe shumë toka të Shqipnis kemi bjerrë e jo vetem keta 4 copë mure të Sh. Naumit e nji pjesës të pyllit të Vermoshit. Këto karshi humbjevet të përparshme janë fortë vogla, po me gjithë se janë të vogla, mos-pasja e tyre për në asht e idhët, pse këto kanë nji randësi politike, strategjike e historike. Po kur kemi 1 Milion e ca Shqiptar qì janë jashta kufinit t'onë, ato 4 mure nuk mund të losin nji rol.

Si na tha edhe i nd. Delegati i jonë Z. M. Frasher. neve kur kishim ndër mend Sh. Naumin, mendoshim nji Sh. Naum me rrethinat e saja, menjoshim atë kufi, ku ushtritë aleatë luftoshin karshi të tjernet. Ky ka qenë

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVE

nji kufi ideal, dhe mbretërit e Mdha-ja lypsesh ket kufi t'i a epshjn Shqip-nis po mjerisht na apin vetem 4 muret me nji largesi 760 m. Ç'rol mund të losin e ç' randësi mund të ketë Sh. Naumi me ketë largësi e kupton se-cili. Sikur të kishte rrithinat atëhere po, do të kishte randesi, përkundrazi në lindja na hyen ma thellët, dhe ka-tundet të banueme prej Shqiptarësh po i mbeten fqinit t'onë. Po shofin se fqi i jonë, sa do qi Mbretnit e Mdha e Gjykatoren Naltë e La Haies na e kanë dhanë neve, nuk po donë me e Ishue. Mbretnit e Mdha kur kan formule e atë vendim, me njanen dorë na kanë dhanë e më tjetren na kanë marrë, e na lanë në nji grindje të merzitshëm që nuk po dijmë si të da-lim. Tashti, për nji pikë të tillë a ly-pet të hapim nji lufiqë? Të thuesh jo, asht këq, të thuesh po, poja ka manatë e veta. Me qenë se Mbretnit e Mdha na kanë dhanë vetem 4 muret e monastirit të Sh. Naumit, dhe Ju-gosllavia na proponon nji shkembim me Peshkupën me tokë 4 herë ma-teper e ku banojnë 50-60 familje shqiptarësh mbassi Sh. Naumi me caktimin e kësaj vije e humbi randësin si ekonomike si strategjike, unë jam i mëndjes që me konditat që përmendë raporti i Kom. të Jashtëm të Dy Dhomavët t'i epet autoizimi Qeveris të hyen në marrëveshje me Qeverin Ju-gosllave për nji shkembim miqësish.

Tani vimë tu çështja e Vermoshit. Si tha i ndershmi delegati i jonë Z. Mehdi Frasherri, këtu nuk asht çështje

se po japim Vermoshin, jo Zoteni, Vermoshi na mbetet neve, neve japim vetem nji pjesë të pyllit të Velopojes dhe për ketë po na epet nji tjeter. Pra, duhet të mos bajmë demagogira, se të drejten t'onë e dijmë të gjithë, po nuk kemi forcën t'a marrim.

Të kemi kurajo të përbushim de-tyren e randë që na ka ngarkue po-pulli, se populli do qetësi, do punë, do bukë, dhe mbassi po na jepin nji tokë 15 herë ma të madhe t'i jepim autorizimin Qeveris dhe mos kujoni se me pasjen apo mos pasjen e Sh. Naumit populli do të lulezojë, se po-pulli do të jetë i lumtur me Qeverin e me përfaqesuesit e tij, kur keta t'i sigurojnë qëlesin e buken. Sot në ketë Asemble kemi diten e mrapshme të kufivet shqiptar se po i jepim fund çështjes së kufivet mb'anë të Jugosllavis. Çështja e kufivet mb'anë të Grekut asht mbarue edhe tani mbetet çështja e kufivet shqiptaro-jugosllav që me marrëveshje që do të bajnë Qeverija do të kryhet, dhe kështu do të ngjallet miksija fqinjore e do të lidhim të gjithë ato traktate tregtije e ekonomije për të cilën kemi nevojë.

Bahen 5 minuta pushim e pas 5 minutash, mbledhja mbështjellet prap.

Z. KRYETARI Shomica asht, mbledhja hapet.

Z. XH. DINO: Z. Kryetar, ZZ. Se-nator e Deputet! Të ndershmit para-folsë e kan shpjegue çështjen fare mirë. Mue si relatori i komisionit të përbashkët kam detyrë, shkoqis pika si

BISEDIMET E DHOMEËS SË DEPUTETVE

nga pikëpamja ekonomike, si nga pikpamja materiale. Pikë sparit kemi folur për prestigjen e kombit Shqiptar; domos prestigi për në asht një shumë e madhe, po këte e kan edhe të tjeret. N' asht se kemi ba më tinge, këto jan ba edhe pertej kufinit t' onë. Për t'i u sjellun një shembell Z. s' Uej, do t'i thamë, se Mbreti e Mbretënesha e Jugosllavis vanë e panë Sh. Naumin dhe mos pandeheni se këjo asht një çeshtje vëzale për në, po edhe për ata. Kush asht ai Shtet që mund t' insistoj për prestigi? Mue më duket se përgjithësisht kan të drejtë t' insistojnë ata Shtete që janë të fuqishem. Si kur të bajmë fjalë për prestigjin e Francë a po t' Igilterrës, ata kan hak t' insistojnë. kur se Shtetet e vogla janë në një pozitë ndryshe. Raporti i komisjonit ka shumë pika materiale e ekonomike për në, po si duket këto nuk u muren prej disave aspak parasyesh. Këto pika duhet t'i kujtoj dhe një herë. Në raport thomi që karshi kater mure të Sh. Naumit, Qeverija Jugosllave na jep tokë katër herë ma të medhja, oa jep dhe një katund të banuem prej Shqiptarësh prej afro 100 familesh Shqiptar; nga ana tjeter Qeverija Jugosllave na nep edhe Valaten e Çeravës, prej të cilës mund të kemi shumë avantagje. Kufini që asht propozue asht n'avatangje t' onë se siguron rugen Pogradec, Korçë e Elbasan.

Vimë tashti të çeshqja e Vermoshit. Parafolsit e ndershem e shpjeguem fare mirë se neve nuk japim Vermoshin, po japim vetem një pjesë të vo-

gel. 1[4] d. m. th. nji pyllë të vogel. Si na tha., Z. M. Frasher, dje edhe sot edhe në kohë të Turqis n' ato vendë ishin grindje. Pse t' i mbajmë gjithnjë edhe sot ato grindje; më duket se asht një avantagj për në t' i apim fund.

Midis të dobinave të tjera që do të kemi, sikurse shkruhet edhe në rapportë Shqiptarët do të ken liri të plotë të hyejnë e të dalin pa pasaportë e të bajnë tregti pa pague taksë doganore.

ZANA : A asht zyrtarisht këjo....

Z. XH. DINO : Un nuk iam zyrtar po Qeverija le t'a thonë, dhe un e admetoj në këto baza n' asht se kristalizohën këto fjalë. Pastaj katundet e rrëthënët e Gjakovës, të Dibrës e të Prezendent do të ken liri të plolë të tregtojnë pa pague taksë; sot për sot gjithë këto katunde gjinden në një gjendje fare të vishtirë nga shkaku se nuk kan një pazar.

Këtu asht një interesë reciproke. Pastaj do të kemi shumë avantagje të tjera prej akordeve të ndryshme që mund të bahan midis Shtetit Shqiptar e Shteti Jugosllav. C'do akord kërkon atmosferen që të dy Shtetet limitrofe të jetojnë në relacjone miqësore, se ndryshe akordet nuk mund të bahan. Marrim çeshtjen e Fjumes: Më gjithë që Jugosllavija ishte një Shtet i mathë, me qenë se një Shtet i mathë nguli kamb për te, ju desht me gjetë një modos-viventi për të mprojtn interesen e përgjithshme, dhe Jugosllavija bani një sakrific tue e lëshue

L'IS EDIMET E DHOMES SE DEPUTETVE

Fjumën Italis, dhe Itali nga ana tjetër lëshoj Jugosllavis porto Baros. Kur Shtetet e mëdha bajnë të tillë akorde, pse neve nji Shtet i vogël mos t'i bajmë.

Z. F. RUSI: Ato vende ishin t'Autris

Z. XH. DINO : Sovraniteti nuk ka ken i pranuem. Më duket se çeshtja u shpjegue mjaft edhe se i cili prej nesh si mbas ndërgjegjës të japid nji vendim.

Z. F. RUSI : Z. Kryetar ! Në fjalën që mbajti Z. M. Frasher Delegati i jonë në komisjonin e kufive na tha se komisjoni i kufive në vijen e Pogradecit pat vodos kufinin natyral, po çeshtja kur shkoj në konferencen e Ambashatorve, si mbas kërkeses së bame prej Qeveris Jugosllave, ky vendim ju referue Lidhjes së Kombeve dhe s'andejmi shkoj në gjykatoren e La-Haies dhe atje u veitetue e drejta e jonë. Prej andej këthej prap në konferencen e Ambashatorëve e cila që të vertetote kufinin natural, bani nji ndryshim në favor të Jugosllavis uhe caktoj nji kufi në të cilin mbeti vetem ndertesa e Sh. Naunit. Më ketë mënyrë konferanca plotësoj indirekt deshirat e Jugosllavis në koriz t' onë. Nga këjo kuptohet se të vegjlit nuk kan përkrahje, se në koriz të vogjelëve jepen vendime e fortë gjithmonë këtë drejtë.

M'anë të tjeter për me plotësue deshirat e Jugosllavis, thohet Qeveris Shqiptare meru miqësish me Jugosllavin.

Kundrejt kësajë proponimi q'i babet Qeveris Shqiptare me bë një shkembim tokash nuk e di a asht një sodisfacion për Shtetin Shqiptar, këjo asht një çeshtje që do të gjykohet mandej; po me qenë se Shtetet e mëdhaja nuk nă përkrahin, për me mbajtë relacjone të mira me fqinit t'onë, edhe un jam antar që të pranohet që Qeverija të hyjnë në marrëveshje, tu e mbeshtetun në porosinat e Qeveritarëve të mëdhai, e që kan besim të plotë se t'a ruejnë nderen e Shtetit t' onë.

Z. R. FICO : Zoti Kryetar e Zotni të ndershëm !

Të katër muret e Kishës së Sh. Naunit për mue nuk kanë ndonji vlefte thuhet se për këto do të na japid Peshkopin, ku do të ketë edhe atje një kishë. Pylli i Velipojes edhe ky ka qenë gjithmonë edhe në kohë të Turqis shkak grindjesh.

Kam qenë i vogel, kur ishe në Shkodre se kishe baben t' em kadi atje, dhe e mbajë mend kur ishte Qerim Pasha vali në Shkodre patë ngjatë nga'resa aqë sa Qerim Pasha u emend dhe iku e la Shkodren. Nëmen të drejtësis ndërkombtare do të donja që e drejta e ilamit të Gjykatores së naltë të La-Haies, andra e diftueme prej Lidhjes së Komeve pralla e persritun prej Konferencës s'ambashitorëvet për nderin e njerzis te respektohesh do të donja t'a kishim ket sodisfaktion, po mjerisht fati i jonë nuk po na do, Shqipnija pësoj operation mbas operacionit, humbi Kosovën, humbi Çamërin humbi 1 Mi-

BISEDIMET E DHOMES SË DEPUTETVET

lion e ca prej bijvet të sajë që gjinden Jashtë Kufinit, tashti po i bahet një operation tjetër. Na thonë të japim Velopojen, të japim Sh. Naumin. Po edhe këto do të i a japim ! Due të them Z. Kryetar se e drejtë nuk ka vlefë, kush ka fuqin, ai e ka të drejtë në dorë!

Mbassi do t'i humbasim këto vise e do të pësojmë prap një operation mbi kurrizë t, Atmes s' onë ne mos tjetër Qeverija e jonë të përfitojë nga ky shkembim të kerkojë shkollat shqipe në Kosovë ku kemi ma se një Milion vllazen t'onë, të kerkojë me dergue Konsulloz në Shkup, e ne Prizend Serbit, në Shkodrë, ku kanë vetem 1500 serbëfon kanë Konsullat e kanë shkollë. Jemi të shternguem t'i japim lejen Qeveris s' onë të hyen në marrëveshje me Qeverin Jugosllave, po lypset të dihet se këjo asht një plagë e pa-sherueshme në zemer e në truët t' onë, e sikur pritën Serbit 4 shekuj per të realizue idealin e tyre, ashtu do të presim edhe neve, atë oren e bekuar që drejtësia do të mundi fuqin dhe do t'i drejtojmë djemët, nipët e sternipët t'anë, dhe dikur këmbazi, duerazi, barkazi do të vemi në Kosovë njen hijen e shkabës dykrenore. !

Pra i jap lejen Qeveris, dhe e porosis edhe njëherë të ngulin kembë për të dergue një Konsul në Shkup e Prizend e të çelin shkolla shqipe atje, se të drejtat janë reciproke, se sikur Serbit kanë Shkollë e Konsullade në Shkodrë ashtu duhet të kemi edhe në atje.

Z. TEF GERA : Z. Kryetar ! Sa do që nuk jam i mendjes që të bahan këto shkembime duhet të pyes komisionin i cili na dijtë se kanë me i ardhë shumë dobina popullsis së Dibrës e të Kosovës, se kanë me hye lirisht e pa pasaportë e s' kanë me la taksë doganore për giana që të çojnë në jugusllavi. a efdi se kemi disa kattunde Anen e Malit e Krajen të cilët bajnë tregti me Shkoder. Për këto si edhe për punë t' ujitet që na ka mbledhë e porosis Qeverin që të hyejnë në marrëveshje me Jugusllavin.

Z. EREBARA : Tani do të baj pak istori e këtij evenimentit të ri.

Po thuhet katër muret e Monastirit të Sh. Naumit, po Zetërinj, kater mure jan tyrbja e Sulltan Muratit e Kisha e Deçanit. Po thohet se Jugusllavija e kë kon S. Naumin se ky shejt paska qenë Sllav. Isteri i Zotëni asht në mejdan. Që n^a fillim të Kristjanizmit qysh në kohë të Romakëve afer Shekullit 9-10 qindron ky Monastir. Në kohë të Car Boris të Bullgaris asht një Bol. Bogdanit që ka qenë në 1751 Argjipeshk në Ohri. Ky i shkruen Papës me atë Bal që po më vinë shumë pengime nga ata që nuk flasin gjuhën e këtij vendit. Papa i përgjegjet se asht n' interesës të rishë atje. Ortodokëst që nuk flitëshin gjuhën shqip nga njena anë dhe Shqiptarët që ishin rethë e rotullë nga tjetra anë, ngrënë e bejnë një shkresë e ja dërgojnë Ipeshkvit edhe ky ja çon Papës dhe Papa i thotë ban ç'ka të duesh. dhe ky ngrehet e shkon në

BISEDIMET E DHOMESE SE DEPUTETVE

Shkupë.

Konferenca na ka rejtë "Selam a-leqem këndej e aleqem selam andej", Sa për qia ate thotë Delegati i jonë se janë kater mure e nuk ka asnjë vlefte materjale e morale, vetjet ashtu asht...

Për mos me shkue me gjatë thamt' autorizojmë Qeverin edhe baj apel në patriotizmen e tyne t'a shkatrojnë këtë punë si të jetë e udhës.

Z. F. VOKOPOLA : Z. Kryetar ! Si u këndue ma përparrap raporti i komisjonit miksi, kërkova lejen të mbaj, fjalë e mbasi çeshtja të bisedohesh gjanë e gjatë riservova fjalën t'ime përpërsë dytit. Z. Kryetar ! Kishe arasye të plotë qia kërkova të na epe-shin shpjegime, të riheshin mendimet e të zhvillohesh çeshtja përparrap mble-dhjes. Nuk pata frigë nga responsabiliteti kur kërkova shpjegim e edhe Z. Delegati i Qeveris Mehdi Frasher, tuke marrë responsabilitetin mbi vedato shpjegime i dha. Z. Kryetar ! Se cili qia ka marrë një detyrë përsipërmendimin e vet duhet t'a thotë padroje.

Qellimi i jem ishte qia zotimet qia kemi dhan kundrejt popullit, të tre-goj se i kemi mbajtë, qia barra mos ië randojnë mbi në se populli sot me veshtëvet kuptoj se si kan rjedhë punët.

Z. Kryetar ! Si e dini fare bukur Zotérinj, Shteti përbahet nga kombi toka e organizata e Qeveris. Kur cenohet toka, asht cenua krejt organizata. Nga B'sedat qia u mbajten këtu mbi pikën e Sh. Naunit e mbi pikën

e Vermoshit, kuptohet se nuk lamë toka të medha, dhe kuptuem se të gjitha propagandat qia janë ba mbi këto pika e deklaratat e Shtypit nuk paskan qenë të drejta, dhe e drejta e jonë nuk qenka pranue plotësisht prej Konferencës s' Ambashjatorëve. Simbas shpjegimeve qia na dha Delegati i jonë Vermoshi i mbetet Shqipëris e vetem një pjesë kërkon Qeverija Jugullave.

Sh. Naumi n'asht lan në, vetem në një qark 750 metresh. Shteti sikur se thaçë përbëhet mbi trij fuqi dhe vjen barasimi vetiut, nga njëna anë lamë e nga tjetra marrim. Z. Delegati i Qeveris, si edhe relatori i komisjonit na shpjeguen fare mirë edhe na t'hanë se lamë Sh. Naumin me një region 750 metrosh, dhe në tjeter anë marim katundin e Peshkopejës, ku banojnë 50-60 famile Shqiptare me 500 shpirë.

Këjo vepër a cenon principin e kombit dhe a siguron interesën e tij ?

Un jam i mendjes, -duhet të kemi koragojo civile e t'a thomi çeltas-, se këjo vepër nuk cenon principin e kombit e jam i mendjes t' autorizojmë Qeverin të hyejnë në marrëveshtje.

Sa për Vermoshin oratorët e ndershem e shpjeguen çeshtjen fare mirë dhe veçanërisht dhe ma t'epërt ata qia kan qene në Shkodër, se për pyllin e Velepojës paskan qenë kurdoherë konflikte, pëaskan qenë shkaktue gjithmonë grindje. Dhe këtu marrim e jampim, dhe nga ana tjeter fitojmë letësina tregtije e komunikacioni etj. Këto

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUZEVET

janë sigurime materjale.

Pika e dytë asht responsabiliteti moral që mban kombin sikur një njeri që e mban ndcri, dhe mbi ketë pikë foli relatori i komisjonit të cili pruni shembell Shtetet e tjerë e tregoj fitimet morale që erdhne prej marrëveshtjeve se sa na e quejmë të cenueshme.

Nuk do të flas me gjak të nxetë, se për me folë mbi ketë çeshije duhet të jemi të fort, të jemi të gatitëshem. Nuk do të flas si vjershator, do të flas si shqiptar me lutje, jo vetem për kombin Shqiptar, po edhe për kombin Balkanik i cili nuk është tr. gue aqë zemer gjanë si kombi Shqiptar. Më ketë godinë kemi bisedue sa herë mbi pa drejtësitë që na janë bâ nga fqint t' onë; këtu kemi pasë rastin të marrim fjalën për të drejta l'ona që në ç' do mënyrë na janë shkelë, jo se kemi heshtë, po kemi qja.

Më gjithë se valet remyese kan dasht t'a fshinë nga faqja e dheut kombin Shqiptar, fuqija jetike, fuqija misterioze asht ajo që na ka mbajt dhe do të na bajnë dhe e drejta, mos sot, neser do t' a gjejnë vendin e sajë.

Tue përsritun fjalët e Z. R Ficos, Qevcrija kur të jap e të marrë të siguroj dobina materjale, po t' i japin rendësi edhe pikës së morale se deshira e popullit Shqiptar asht që këjo grindje me fqin t' onë të marrë fund. Djelmt e Balkanit duhet jenë të lidhur njeni me tjetrin e nuk do të jetë e mundur që në sinisin Ballkanike të roj-

më në grindje e në zjermë.

Sot prandaj i lутем Qeveris që pikës morale t'i apin rendësin ma të madhe e sot t'i epet fund kësajë çështje me deshir që të realizohen marrëdhanjet miqësore midis të dy Shteteve.

Edhe un e jap voten t' eme tue u bindun shpjegimeve të dhanuna, e me kondicjon që baza e marrveshjes të permbahet me shpjegime që na dhanë Z. M. Jashtem e Z. Del. M. Frashërit.

Z. KRYETARI : Çeshija më duket u bisedue mjaft dhe më nepni lejen të ju japë diea shpjegime mbi Art. 2 të Statutit. Ne asht se përfundimi i kësaj çështje është për nji shkembim tokash, pa u ndryshue art. i Statutit nak mund të bëhet se atëherë bejmë nji vepre antikushtetore.

Prandëj duhet ma përparrë t'i shkojmë nji paragraf të vogël art. të Statutit dhe si të pranohet ky atëherë mund të vihet në votë e të marrë çështja përfundimin e duhur. Artikulli 141 i Statutit thotë se ndrimi i Statutit babet me dy të vretat e votave të mbledhjes legislative tue u mbledhë dy Dhomat bashkë. Pa bandrimin e këtij artikulli në mënyrën si e caktos art. 142 asht e pa mundur të vihet në votë e të përfundojme ketë çështje.

ZANA : Jemi d' akord.

Atëherë ne e shifni t' arësyeshëm, neser n' ora 9 mbledhen të dy Dhomat veç e veç edhe japin vendim mbi

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUSEVET

shtojeen apo ndrimin e Art. 2 të Statutit. Ne u pronoftë prej të dyjave, ora në 10 mblidhemi së bashku dhe vazhdojmë në bisedim e i japim përfundim çështjes që kemi në dorë.

Pranohet.

Z. KRYETARI : Atëherë sot puhuojmë, edhe neser të Dy Dhomat mbledhja mbylllet n' ora 7 pas dreke.

Sekretari
Spiro Papa

Kryetari
Eshref Frasherri

MIBLEDHJA E 29.

E Shtunde, më 18 Korrik 1925 ora 10 para dreke

(Kryeson Kryetari : Z. M. Kasso)

Këndohet emnat e Deputetve e mu- sejçila ndër mbledhje të veçanta për
ngojnë ZZ:

A. Hastopalli, K. Kosturi, B. Be- dy të tretat votash mbi vumjen e nji
golli, B. Hamdi, B. Frasher, H. Del- shtojcës Art. II. te Statutit, për me
vina, H. Vrioni, J. Urshdi, L. Llogori, muejt pastaj, në themel të këtyne ve-
M. Tutulani, Q. Durmishi, Q. Virioni, ndimeve me ba mbledhjen e përbash-
R. Mati, S. Popa e S. Stavri. kët t' Asemblësë Legjislativë dhe kë-
shtu me i dhanë fund nji herë e për-
mbledhja. gjithmon çeshtjes të kufinit Shqiptaro-
Jugosllav.

Z. KRYETARI : Zo'ërinj ! Fillon
mbledhja.

Këndohet nji shkresë e Kryetarit
t' Asemblësë Legjislativë.

P. T.

Kryesis së Senatit e Dhomës së
Deputetvet.

Kam nderin me i bamë të njoftun
asajë P. T. Kryesije se Asembleja Le-
gislativë e përbame prej Senatit e
Dhomës së Deputetve, e mbledhun së
bashku mbi proponimin e Shkel.
Kryesis Republikës në mbledhjen e
vet me 17-VII-1925, mbasi bisedoj gja-
në e gjatë edhe mbasi ndigjoj shpje-
gimet e Qeveris e veçanërisht të De-
legatit Shqiptar në komisionin e ku-
five Shqiptaro-Jugosllave, mbasi e stu-
djoj edhe raportin e komisionit të P.
të Jashtme i përbamun prej Misave
të dy Dhomave mbi çeshtjen në fjalë,
për të qenë konformë m'artikullin
141 të Statutit, vendoj me unanimitet
votash, të mbledhen të dy Dhomat

sejçila ndër mbledhje të veçanta për
të marrë vendimin e duheshem me
dy të tretat votash mbi vumjen e nji
shtojcës Art. II. te Statutit, për me
muejt pastaj, në themel të këtyne ve-
ndimeve me ba mbledhjen e përbash-
kët t' Asemblësë Legjislativë dhe kë-
shtu me i dhanë fund nji herë e për-
gjithmon çeshtjes të kufinit Shqiptaro-
Jugosllav.

Prandaj, i lutem asajë P. T. Krye-
sije me u ndermjetësue që mbledhja
të bahet sot.

Pritni nderimet e mijë,

Kryetari i Asemblësë Legjislativë
Eshref Frasher, m. p.

Tiranë, me 18-VII-1925

Z. KRYETARI : Neni II. i Statutit
ka nji të mbet se thotë:
“Republika Shqiptare, asht indipenden-
te, e pa-n dame, tansija e tokës e sajë
e padhunueshme edhe toka e sajë e
pajertueshme.”

Si e shifni nuk ka nji shtesë që e
kan të gjithë Statutet e botës, dhe
shtesa që do të vihet asht këjo: “A-
neksimi, shkembimi i tokës kombtare
bahet vetem me dy të tretat e votave
të dy Dhomave të Pushtetit Legisla-
tiv të mbledhuna bashkë. Çeshtja u
bisedue në ditët e kalueme e tre-

BISEDIMET E DHOMES SË DEPUTETVET

gonet nevoja e nji Shtojcës.

Z. XH. DINO : Për ketë formulim që do të bahet a jeni marrë vesht me Kryetarin e Senatit.

Z. KRYETARI : P. Zotërinj, jemi marrë vesht me Kryetarin e Senatit që të bahet këjo shtojcë.

Z. XH. DINO : Po për formulimin, Z. Kryetar.

Z. KRYETARI : Ketë e cakton Dhoma e Deputetvet vetë.

Z. P. POGA : Nuk kemi të drejtë të bajmë formulimin, po vetem duem të ç' faqim a asht nevoj të bahet këjo shtojcë.

Z. KRYETARI : Për mbi ketë çështje a ka njeri fjalë.

Z. F. VOKOPOLA : Si Mbas urdhënavë Shtaturore e si mbas Art. 141 të Statutit kur asht nevoj për të bë një ndrim, mblidhen dy trupat legjislative dhe jepin nji vendim. Neve këtu kur u këndue letra e Kryetarit Asembleës Legjislative kuptuem se do të bahet shtojca e cila asht e nevojshme; sa për formulimin nuk mund të bahet veç se kur të mblidhen të dy Dhomat së bashku.

Z. KRYETARI : Vihet në votë propozimi i ZZ. F. Vokopolës e P. Poga. Kush asht antar që Art. II i Statutit t'i bahet nji shtojcë të ngreh doren.

ZANA : Të bahet nominale ...

Z. KRYETARI : Vota bahet nominale e ai që asht antar që shtojca të bahet të thonë po, dhe ai që s'do që të bahet të thonë jo.

Bahet thirja nominale e Deputetve si pason :

Abdurraman Sali, po; Ceno Krye-

ziu, po; Elma Xhafer, po; Ferid Vokopola, po; Fiqri Rusi, po; Hamid Muftiu, Abstenon; Hasan Biçaku, po; Hysen Kuqi, po; Hysni Toska, po; Jak Koçi, po; Jashar Erebara, Abstenon; Gjergj Çaku, po; Kasem Radovicka, po; Kasem Seidin, po; Kol Mjeda, jo; Kolec Deda, jo; Kos. Kotta, po; Kristo Floqi, Abstenon; Lon Gjini, Abstenon; Maliq Bushati, Abstenon; Mihal Kaso, po; Mufid Libohova, po; Ndrek Kiçi, jo; Peter Poga, po; Prenk Llesh Gjoni, jo; Qani Dishnica, po; Rauf Fico, po; Sadik Shaska, po; Said Kalaja, jo; Salahydi Blloshmi, po; Seid Toptani, po; Dr. Simonidhi, po; Dr. Syreja Pojani, jo; Shasivar Alltuni, po; Tef Gera, jo; Vasil Bamiha, jo; Veis Sevrani, po; Dr. Woxhori, po; Xhafer Ypi, po; Xhelal Zogu, po; Xhemil Dino, po; Zenel Mandiqi, jo. Munguen në Mbledhje ZZ. Ahmet Has-topalli, Bahri Begolli, Banush Hamdiu Bexhet Frasher, Hiqmet Delvina, Hysein Virioni, Javer Urshid, Kristaq Kosturi, Lon Llogori, Milto Tutulani, Qazim Durmishi, Qemal Vrioni, Rexhep Mati, Simon Popa, Stavro Stavri.

Z. KRYETARI : Gjithësejt Deputet janë 42, dy të treta: bajnë 28 vota, pra përfundimi resulton që:

Dhoma e Deputetve me 28 vota që janë dy të tretat e Deputetve që janë present, pranoj që Art. II të Statutit t'i bahet nji shtojcë.

Z. S. BLLOSHMI : Këtu dje e pëmë nevoj të gjithë, pse nuk tha njeri jo e sot po shof se po e thonë.

Z. K. MJEDA : Deshta t'i tham Z.

BISEDIMET E DHOMES SË DEPUTETVET

së Tij se dje e pardje i paska pasë Z. KRYETARI : S' a nevoj të kë-
vesht me lesh a po me pamuk, se e ndohen proçes-verbalet se seicili ka
kemi thanë dje e pardje dhe e thomi mejtimin e vet.
edhe sot se nuk jemi taraftar që të Çështja u mbarue Zotërinj e mble-
bahet ky ndrim. Po të doj Z. e Tij dhja mbylllet.
mund të këndoj proçes-verbalet. Mbylllet n' ora 10 para dreke.

Sekretari
Ferid Vokopola

Kryetari :
Mihal Kaso

MBLEDHJA E 30

(MBLEDHJA E PERBASHKËT TË SENATIT E TË DHOMËS SË DEPUTETVËT)

(Kryeson: Kryetari i Senatit Z. Eshref Frasher)

E Shtunde, me 18 Korrik 1925, ora 10.20 para dreke

Këndohen emnat e ZZ. Senatorë- me e Asemblese Legjislative,
ve e mungojnë :

H. Xhemali (me leje), Sh. Sereqi (me leje), Sami Virioni, Sh. Verlaci e

Z. Toptani-

Këndohen emnat e ZZ. Deputetve e mungojnë :

A. Hastopalli, B. Begolli, B. Hamdi, B. Frasher, H. Muftiu, H. Delvina, H. Virioni, K. Kosturi, L. Gjini, L. Llogori, M. Tutulani, Q. Durmishi Q. Virioni, R. Mati, S. Popa, S. Stavri e Dr. S. Pojani.

Z. KPYETARI: Shumica asht e mbledhja hapet.

Këndohet shkresa e Kryesis së Senatit Nr. 91-I datë 18-VII-925 si pason :

Kryesis së Dhomës së Deputetve. Kam nderin me i ba të njoftun asajë P. T: Kryesije, se Senati, në mbledhjen e sotçme, si mbas propozimit të Shk. Kryesis s' Asemblese Legjislative vendosi me dy të tretat e votave mbi vumjen e shtojcës t'Art. II. të Statutit dhe në qofiq se propozimi në fjalë pelqehet edhe prej Dhomës së Deputetve të na njoftohet përmes muejt në themel të këtyne vendimeve me ba mbledhjen e përgjithsh-

Nji shkresë identike ju drejtue Kryesis Senatit nga ana e Dhomës së Deputetve.

Z. KRYETARI: Tani sì kuptohet edhe prej këtyne shkresavet të dy Dhomat me dy të tretat e votavet vendue. ne të bahet nji shtojcë Art. II. të Statutit. Tashti mbetet vetëm formulimi i këtij paragrafit.

Z. I. XHINDI. Për me formulue këtë paragraf të formojmë nji Komisjon mikst.

Z. KRYETARI. Më duket se nuk asht nevoj të formojmë nji komisjon se muud të mblidhen ja komisjoni i Ja htem, ja i rregullores i të dy Dhomavet dhe mund t'a formulojnë.

Z. I. XHINDI. Proponimin që e bana që të shpjegohet puna se kam qellim që të kryhet nji orë e ma parë.

Z. V. BAMIHA: Këtu asht nji çeshq q'i përket komisjonit të Drejtësis e duhet të vejë atje. Tu ke qenë se janë kundra ndryshimit të kufinit protestoj.

Z. KRYETARI. Këto fjalë janë jashq temës, se këtu nuk asht çeshq kufinit, dhe çashtja asht nevoja e nji shtojcës t'Art. II të Statutit.

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETEVET

Ketë shtojcë e kan të gjithë Statut e botës, dhe Statuti i Lushnjes e kishë po Asembleja e ngriti. Prandaj protesta nuk ka vend këtu.

Z. V. BAMIHA. Duhet të shenohet nëproc s-verbal.

Z. XH. YPI. Nuk ka të drejtë të protestojnë se gjithësecili voton pas ndergjegjës së vet.

Bafen 5 minuta pushim dhe formulimi i shtojcës t' Art. II, të Statutit i ngarkohet Komisionit të Jashtëm të dy Dhomavët.

(Mbas 5 minutash mbledhja mbështillet prap).

Z. KRYETARI. Shumica asht e mbledhja hapet

Komisioni i përbashkët formulimin e bane, të cilin po ju a këndojmë : E pranosi të ngutshme ?

Pranohet.

Këndohet shkresa e komisionit mikst me datë 18-VII-25 nenskrue proj

Kryetarit Z. P. Evangelit si pason :

Kryesis Pushteti Legjislativ.

Kemi nderin me paraqit asaje së Shkel. Kryesis formulimin e shtojcës Art. II. të Statutit, i cilli u pranue nga ata e komisionit të përbashkët unatimisht, me lutje r'i paraqitet Mbledhjes së përbashkët për studim e aprosim.

Këndohet shtojca e Art. II. të Statutit si pason :

I. „Asnji ndryshim kufinit nuk mund të bahet veç se me një vendim të marun pas dispozita ve të parapamë një artikullin 141 të këtij Statuti.

II. Këjo shtojcë e Statutit hyenë

në fuqi që sot.

Z. KRYETARI: Pas kësajë shtojcë përmes u ba ndonji ndryshim kufinit duhet të procedohet si mbas Art. 141 të Statutit, d. m. th. do të mbledhen dy Dhomat e do të marrin vendim me dy të tretat e votave të përbashkta.

Z. R. FICO : At-herë kur do të jetë nevoj për ndryshim kufinit, të dy Dhomat do të mbledhen veç e veç e do të procedojnë si mbas Art. 141 të Statutit.

Z. I. XHINDI. Nuk asht si thotë Z. Fico për ndryshim kufini, po për ndryshim apo interpretim të Statutit. Kur shifet nevoja e ndryshimit të Statutit, dy Dhomat, e Senatit e Parliamentit mbledhen veç e veç procedojnë në ndrime si pas procedurës t'art. 141 të Statutit, ashtu si kemi procedue sot, dhe pastaj vazhdojnë në mbledhje të përbashkët.

Z. M. KASO. (K. P.) Statuti që asht në veprim i ka mprojt ndryshimet e Statutit me Art. 141 i cili thotë, se këto ndrime merren me dy të tretat votash të mbledhjes së përbashkët të dy Dhomave. Komisioni e quajti të nevojshtëm që edhe ndryshimin e kufivet t'a vënë nën mprojtje të dispozitave të Statutit. Sikur dispozitat e Statutit mund të ndrohen mbas procedurës të Nenit 141, ashtu edhe ç'do ndryshim kufinit lypet të mprohet nga Statuti siku se mprohet ndryshimi i Statutit, d. m. th. kur të quhet një nevoj ndrröhët kufini o përtë mirë o përtë keqë, Dhoma e Depu-

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETEVET

tetve nuk ka të drejtë të bajnë një ndryshim, po duhet të mblidhen të dy Dhomat dhe me dy të tretat e votavet të vendojmë.

Z. R. FICO: Më duket se me ketë shtojcë t' artikullit sigurohen interesat e Shtetit ma së mirit e jâm antar të pranohet sikur e ka paraqit komisioni.

Z. XH. DINO. Z. Kryetar! Do të flas shkurt, vetem due me kjarue një pikë. Z. Kryetari i Parlamentit tha se Asembleja çë do herë mund të ndryshoj një pikë kufinit tue procedure në bazë t' art. 141 të Statutit. Më duket se kjo deklarat asht alarmante, se ndryshimi do të bahet vetem për ketë herë, mbassi kan mbet këto dy pika. Prandaj mos t' alarmohemi dhe kjo shtojcë asht shum e mirë.

Z. F. RUSI. Nuk më duket e mjaf-tueshme; për me pasë një autorizim a duhet me ba Parlamenti një ligjë?

Z. S. VUCETRINI. Z. Kryetar! Më duket se këtu kemi një mosmarrëveshtje.

Nuk jemi tue bisedue për autorizim, po për shtesë t' art. 2. Ky artikull i Statutit ka një mungesë, ka nevoj për një shtesë dhe shtesa asht ban'atë mënyrë si e ka ba komisjoni, si në rasë të nevojës ndonji ndryshimit, ky ndryshim mund të bahet me vendimin e dy Dhomavet në bazë t' art. 141 të Statutit. Ky art. asht fare i mire dhe bisedat të bahan mbi shtojcen e art. 2 Statutit e mos të hyejmë në bisedim për autorizim.

Z. KRYETARI. Tani po e ve në

votë, dhe votimi bahet me thirrje nominale, ai që thotë po d. m. th. se pranon shtojcen e art. 2 të Statutit sikur e ka paraqit komisjoni mikst, ai që thotë jo d. m. th. se nuk e pranon.

Bahet thirrja nominale e Senatorëvet si pason:

Z. Abduraman Dibra, po; Z. Anton Beça, po; z. Eqrem Vlora, po; Eshref Frasher, po; z. Halit Roji, po; Z. Hafiz Xhemal (me lje); z. Ibrahim Xhindi, po; z. Isuf Gjinalli, po; z. Nafiz Dervishi, po; z. P. Evangjeli, po; z. Petro Harito, po; z. Pjetër Shan Deda, jo; z. S. Vuçetriti, po; z. Sami Virioni (mungon); z. Spiro Papa, po; z. Sh. Verlaci (mungon); z. Shuk Sereqi (leje); z. Zia Toptani (mungon).

Bahet thirrja nominale e Deputet-vet si pason:

Z. A. Sali, po; z. A. Hastopalli, (mungon); z. B. Begolli, (mungon); z. B. Hamdi (mungon); z. B. Frasheri (mungon); z. Ceno Kryeziu, po; z. E. Xhafer, po; z. Ferid Vokopola, po; z. F. Rusi, po; z. H. Myftiu (mungon); z. H. Biçaku, po; z. H. Delvina, (mungon); z. H. Kuqi, po; z. H. Virioni (mungon); z. H. Toska, po; z. Jak Koçi, po; z. J. Erebara, po; (par se kuptova e tani e pranoj). z. Javer Urshid, po; z. Gj. Çako, po; z. K. Radovicka, po; z. K. Seidini, po; z. K. Mjeda, jo; z. K. Deda, jo; z. Kristaq Kosturi (mungon); z. Kristo Floqi (mungon); z. Dr. Loni Gjini, (mungon); (len Dhomen po sa nisë

BISEDIMET E DHOMES SË DEPUTETVE

votimi) z. Lon Llogori (mungon); z. Maliq Bushati (Abstenon); z. Mihal Kaso, po; z. Milto Tutulani (mungon) z. M. Libohova, po; z. Ndr. Kiçi, jo; z. P. Poga, po ; z. Prek Llesh Gjoni, jo; z. Qani Dishnica, po ; z. Qazim Durmishi, (mungon) ; z. Qemal Virioni (mungon) ; z. Rauf Fico, po ; z. Rexhep Mati (mungon) z. S. Shaska, po; z. Said Kalaja, jo; z. Salahedin Blloshmi, po; z. S. Toplani, po; z. Dr. Simonidhi, po ; z. S. Popa, (mungon) ; z. Stavro Stavri (mungon, z. Dr. Syreja Pojanë (mungon, len Dhomen po sa nisë votimi). z. Sh. Alltuni, po; z. Tef Gera, jo, z. V. Bamiha, po; z. V. Sërvani, po; z. Dr. Voxhori, po; z. Xh. Ypi, po ; z. Xhe-lal Zogu, po; z. Xhemil Dino, po; z. Zenel Mandiqi, jo.

Z. H. ROJI : Z. Bamiha a iha po a jo?

Z.K. MJEDA. Z. e Tij kà qindrue qysh heren e parë për jo, dhe Z. Yte s' ka të drejtë m' u përzi, dhe ne paç marak hajde e shikjo Proçes-verbalet.

Z. V. BAMIHA. Un thaçë po.

Z. KRYETARI: Shuma e përgjithshme e Senatorëvet e Deputetvet prezant asht 52, kështu qì për po, janë 43, 8 jo e 1 Abstenim. D. m. th. se me ma teper se dy të tretat u pranue shtojea e Art. II. të Statutit sikur e ka paraqit komisjoni mikst (e ngutëshme).

Për me vazhdue në bisedim bajmë 5 minuta pushim.

Z. KRYETARI : Shumica asht e mbledhja hapet.

Zotërinji ! Dje biseduem mbi çeshqjen qì na kishte kërkue Kry-sija e Republikës, fjalët ishin mbarue edhe e lamë të bajmë shtojcen e art. II. Statutit; dhe këjo u mbarue, tash-ti të vazhdojnë në bisedim.

Z. M. LIBOHOVA. (Zav. M. i Jashtem) Qeverija ka paraqit nji propo-nim, lutem të këndohet.

Këndohet proponimi si pason :

Senati me Dhomen e Deputetvet të mbledhun së bashku, sot me 18-VII-1925 për të biseduar mbi çash-tjen e kufive Shqiptaro-Jugosllav, pran-on në parim Ad Referendum nji shkembim toke midis dy Shteteve dhe autorizon Qeverin të hyejnë në marrëveshtjet e duhura konformisht me interesat e Shtetit dhe të popullit Shqiptar.

Pranohet.

ZANA. Fjalen ad referendum s'e muerme vesht.

Z. M. LIBOHOVA. (M. i P. të Jashtme) Fjalen ad referendum e kemi ven se marrëveshtjen nuk do t'a bajmë definitivisht, po në sesjonin e afërmë do t'i u paraqesim Z. së Uej për vertetim, dhe n' asht se e prano-ni atë-herë hyën në veprim.

(Duetrokutje)

Z. M. KASO. Edhe unë jam i mendjes qì autorizimi Qeveris t'i epet po me nji diferençë, dhe ndryshimi asht kështu :

Pushteti Legjislativ, d. m. th. të dy Dhomat, të mbledhuna së bashku, në mbledhjen e sotshme, si mori para sëshë shpjegimet, arësyet dhe mej-

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETEVET

timet për çeshtjen e kufinit shqiptaro-jugosllav të paraqitun këtij Pushteti në ditët e shkuar në mbledhjet me dyer të hapuna a me dyer të mbylluna prej të Z. Ministrat të Punvet të Jashtme dhe Z. Mehdi Frasherit, Delegat i jonë në Komisionin e Kufivët, e edhe ajo çeshtje u bisedua gjerë e thellët vendosi:

1) t'i rekomandojë Qeveris, sa ma shpejt t'i japë kësaj çeshtje nji përfundim definitiv, si ajo të kuptojë se asht mirë për Shtet.

2) Për ato qellime, delegatit në fjalë Z. Mehdi Frasherit t'i japid instrukjonet e duhuna.

Z. M. LIBOHOVA: (Zav. M. P. Jashtme): Qeverija ketë nuk e pranon se pa e paraqitë çeshtjen përsri përratifikim para Zotnis s' Uej, Qeverija nuk do të bajë hiq gjë.

Duertrokite.

Qeverija Zotérinj do të bajë marrëveshje edhe kur të mbarohen këto, në sesjonin e aferm do t' Ju paraqiten për aprovim. Kur Zotnija e Juej t'a pranoni, atëherë Ministri i P. të Jashtme do të venë nenshkrimin e tij, ndryshe nuk mund t'a firmojmë.

Duertrokite.

Z. K. MJEDA. Zotni të ndershëm! Tash tri ditë që po rihet këtu këjo çeshtje kaqë me randësi, dhe unë tue u mbështetë në koscienceën e ZZ. të ndershmevet Senator e Deputet u mundova të ja mbushi mendjen që pretendimet t'ona t'u merrshin parë syshë, po mjerisht nuk u mueren. Me gjithë që jamë kundershtarë që mos të

bahen këto shpjegime, sot po shof nji atmosferë tjeter. Sot po shofim të ndershmin Z. Ministrin e P. të Jashtme se na bam nji propozitë, nji konscience që duhet më mendue për kufit e Shqipnis e jo ashtu me nervozitet ose me të shtyeme. Tue u mbështetun në patriotizmen e Z. s' Uej. me gjith që kemi shumicen e votavet e ndofta nuk i jepni randësi anës s' onë, Ju lutem me gjith shpirtë si Senatorvet, Deputetvet e posaçerisht Qeveris që mos të damtohet krahi i Prefekturës së Shkodrës.

Z. M. P. J. (M. LIBOHOVA.) Ministri i Punvet të Jashtme nuk ban nji distincjon midis katundit të tij Libohovës e të Velepojës. Të jeni sigurët Zotnija e Juej se do të punojmë me konsciance, dhe besonje se na dhemb shpirti!

Z. F. VOKOPOLA. Z. Kryetar! Dje edhe sot bisedojmë dy gjera, të ndara njera prej tjatres. Ma përparrana u të faq nji nevojë të për interesë Shteti, dhe e dyta nevojë të bajmë nji shtojcë të Statutit mbi bazen e tij. Paragrafi në fjalë për shtojcen e Shtatutit u volue e ajo nevojë u plotësue. Këtë nevojë une edhe në kohë t'Asembleë Konstituente e kan mprojtor, se Statuti i Lushnjës që asht baza e këtij Statutit e ka. Disa nga shokët, ma shumë kolegët t' onë të Shkodrës, tue marrë parasyesh gjylpanen që po futet në zemer të tyne, paten arësy me tregue disa kundërshtime,

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTEVET

po Z. Kryetar, kurdoherë nji gjasë sëmuet duhet t' i jepet ilaçi, ilaçi kurdoherë eshtë i hidhur e jo i embël, dhe shumicë e Asemblese Legjislative në bazat e Statutit, ilaçin të smuëtit i a dha, e i siguronj Zonit e Tyre se ky qe qellimi i shumicës, dhe shumica bani detyren e sajë patriotike, ndonse disa shokve t' onë ky i ngjanë i idhië Deklarata qı na bani Qeverija me anen e Z. Ministrit të P. të Jashtme asht fare e kjashtë, dhe nuk duhet t' dyshojmë aspak se Qeverija e jonë do t' bajë veprime t' cilat do t' janë jashta ndergjegjës kombtare, dhe nuk do t' dyshojmë se Qeverija e jonë do t' i japin përfaqësuesit t' saj instrukjonet e duhuna në bazë t' deshiravet t' shfaqura si nga shumica ashtu nga pakica. Prandaj Z. Kryetar, me duket se sot nuk bejmë gjë tjatër, veç se i japim autorizim Qeveris t' hyej në marrëveshtje t' bazueme në ndryshimin e Statutit qı bamë, e në sesjon t' aferm t' na paraqesin për aprovim. Unë për vëtën t'ime i lutem Qeveris t' rrinë rrëth fjalëvet t' saja qı foli këtu n' Asemble e t' i jape fund qeshtjes kufinit; e dijmë e dhe na se ku i kemi kufit t' onë.

Z. XH. YPI. Z. Kryetar! Me qenë se sot nga toka Shqypnis, që po shkëputen disa toka, çdo njeri nga populli e sidomos deputetnit e atyne krahinave ndijnë nji idherim t' math. Po idherimt ma t' math e ndijmë neve deputetnit e Shkodres e t' Korçës, se në këto dy distrikte po i këputën prap gjymtyrët e Shtetit. Due t' i ja-

pë nji përgjegje t' shkurtë kolegut t' Shkodres Z. Kol Mieda, i cili tha se neve qı dhamë voten t' onë pronuk i dhamë rendësin e duhur kësajë çështje. Të jetë i sigurët Z. e tij se i japim randësi shum t' madhe, po interesa t' mdha t' Shtetit na shterndguen t' a japim, dhe kjo eshtë kundra vullnditet t' onë. Qeverija si pas ekspozes qı na bani t' shkëmbuje a-toka me tokat e tjera dhe çështjes së kufinit t' i jepin fund dhe në sesjonin e aferm t' na sjellin marrëveshtjen për votim.

Z. M. KASO. Proponimin t' im Z. Ministri i P. të Jashtme e kuptoi shumë keq. Nuk thashë Zotërinj qı Qeverija t' vendojë e t' mos pyësin Dhomen e Pushtetit Legjislativ, po thashë t' i jepet Qeverisë autorizimi, si t' a kuptojë se ashtë ma mirë për interesë t' Shtetit t' a perfundojë çesh-tjen. Vendimi definitiv do t' vijë në Dhomen t' Asemblese, ajo eshtë e ditur, asht siç e thotë Statuti.

Zotëria e Tij thotë se nuk venen shkrimit, po t' tillë nenshkrime z. Ministri i P. të Jashtme ka venë shumë, dhe nuk ka pyët as Dhomen e Deputetvet e as t' Senatit.

Duetrokite.

Uue i rekmandoj Z. Min. e P. të Jashtme t' a perfundojë ket çashtje mirë e definitivisht si do t' a kuptojë se asht n' interesë e për dobi t' Shtetit. I tham Zotnis së Tij mos t' ketë frigë, t' venë nenshkrimit se aj përfundim do t' jetë për dobi t' Shtetit se e kuptoj kështu qı nji Qeveri

BISEDIMET E DHOMESE SE DEPUTETVET

shqiptare gjithnj do t'ë punojë për nistrit P. Jashtme si dhe nga shpjetobi të Shtetit. Un prisnja se Z. Ministri i P. të Jashtme do të falënderonte për proponim që bera, e jo t'ë me kundershton.

Sa për atë që thotë Z. Xhafer Ypi se do të humbim a do të fitojmë, atë nuk e dijmë se me marrëveshtjen që do të baje Qeverija mund të kemi hem qar e hem zarar.

Prandej kerkoi që Qeveris lypet t'ë japim autorizimin t'ë qapim çeshtjes së kufivet një përfundim me rezultat definitiv.

Duetrokitje.

Z. M. LIBOHOVA. (M. i P. t'ë J.) Kur një Minister i Jashtem kontraktton me një Shtet t'ë huej e ven nënshkrimin e tij definitivisht, dhe ajo marrëveshje paraqitet këtu e po që se nuk pranohet, si do t'ë baje?

Do t'ë lëpjtë firmen e tij. Unë nuk jam as trim as frigacak, po nuk jam edhe aqë trim sa t'ë më kreni Z. e Juej me shkelme jashtë.

Bravo.

Z. K. SEIDINI. Z. Kryetar! Mbledhja që muer formen e Asembleës, në bisedimet që u banë si me dyr t'ë mbylluna ashtu me dyer t'ë çelta, refue se ç' randësi e ç' meritë ka çeshtja në fjalë. Na dishronte zemra që fqi i jonë që ka një popullsi prej ma se 13 Miljonsh mos t'ë na thete zemrën që e kemi t'ë thyeme prej damevet e rreziqevet që kemi pasë, po mjerisht qenka shkrue se forca komandon t'ë drejtë. Nga shpjegimet që na dha Qeverija me anën e Z. Mi-

nistrat P. Jashtme si dhe nga shpjetimi t'ë delegatit t'ë posaçem pranë Komisionit të kufivet, kuptuam qëllatë se lypset t'ë sjellim edhe një herë gurët e kufinit t'ë onë per interesat t'ë nata t'ë Atdheut t'ë onë. Una, tue marrë para syshtë që ato ndryshime përsërisht janë në favor t'ë Atdheut t'ë onë, jam i mendjes që Qeveris t'ë epërt kompetencia e nevojshme për rregullimin e kësaj çeshtje.

Z. R. FICO. Dje, kur folet mbi ketë çeshtje, mue m' ishte mbushë mendja se as 5 per qind nuk do t'ë fitojmë ato vise e prandej u bashkova me mendimin e t'ë gjith shokve. Ato Zotërinj që kundershtojnë, le të na trajognë një shpresë t'ë vogël se mund t'ë fitojmë ato vise, dhë jam gati t'ë këtë hej voten t'ime. Serbit duhet t'ë mos harrojnë në vjetin 1915 kur erdhën në Shqipëri, dhe duhen t'ë mos t'ë na shkelshin sentimentin t'ënë komtar kaqë fort.

Unë Qeveris bashkë me autorizimin që do t'ë ja, si e thashë, i lutem që në këtë marrëveshje t'ë kenë parë syshtë shkollat e Konsulladet. Z. Min. i P. të Jashtme me proponimin që beri, shtini edhe fjalen ad referendum t'ë cilën se mora vesht mirë.

Z. M. LIBOHOVA. (M. i P. J.) Në akte nderkombtare janë sa fjalë, sikur këjo, dhe neve e shtimë atje që t'ë kuptojënë edhe jashtë kufinit, e dijmë se Qeverija nuk asht e zonja me punue në mendje t'ë vet. Lutem këtë fjalë Z. Reuf t'ë m' a pranosh.

Z. R. FICO. Kur e ke me qellim

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTEVET

qi të kuptonet jashtë, me gjëzim t' a sikur ishte në 1913 me të gjitha ato pranoi.

Z. S. BLLOSHMI. Z. Kryetar ! Çeshtja nga t' a kapish ashtu vetë talenti oratorik e kështu këthen nji çeshtje o për të mirë o për të keq, nji orator i mirë nji çeshtje që asht për të qa, e sjell për të qeshë, dhe nji çeshtje që asht për të qeshë e sjellë për të qa. Qe pari ndigjume fjalë se po na pikillon zemra se Shqipnis po i këputen dy copa. Të mëremi vesht këtu a po i këputen, a ç'po babet këtu ? U folë dje e sot gjëre gjatë mbi ketë çeshtje, dhe këtu po babet nji ratifikim kuf ni, se sikur t' ishte ba nji shkëputje nga copat të tokës Shqiptare, atëherë do të kishim folë fjalë të tjera, dhe sado që nuk kemi fuqi, për gjallë nuk do të kishim thanë po. Këtu asht çeshtj e Shnaumit e Vermoshit. Sa për Vermoshin Z. Delegati i Kufivet Mehdi Frasherri na dha shpjegime, dhe ushtriya komtare gjindet atje Zotërinj; atje asht vetem nji pikë, nji faqe malit që e quejnë Velopojë. Mund të ketë prej Z. S' uej që e dijnë këtë çeshtje mund të ketë që s' e dijnë, dhë unë si oficer që kuptoj nga harita, atje asht vetem faqja e malit mb'anë të prendimit, Velopoja e cila nuk ka qen kurr n'okupacion t' onë. Këtu duhet da pika geodozike e pika e piramidhevët, dhe atje piramidhet Komisioni i Kufivet nuk i ka pasë vuë kurrë.

Sa për Sh. Naumin, e dijnë edhe Korçarët, se kur kemi mendue Sh. Naumin e kemi mendue me nji kufi

sikur ishte në 1913 me të gjitha ato pika si nga pikëpamja ekonomike e strategjike, e jo kështu 4 mure.

Z. J. EREBARA. Për ato 4 mure vajten mbreti e mbretëresha e Jugosllavis atje.

Z. S. BLLOSHMI. Ketë çeshtje mund t' a barabisim me trup. Kur në trup nji gisht asht i smuët e nuk ka derman, lypset operecjon, asht ma mire me pre gishtin se sa me lanë me shkue trupin. Nga pikë pamja ekonomike po të mbesë çeshtja e mvarun kemi dam. Kufit nga ana e Serbis prej 500 km janë pa u mbarue, dhe nuk kemi asnjë protokoll definitiv, për arëspe të këtyre visevet e të 4 murevet të Sh. Naumit. A asht ma mire të lamë nji kufi kështu pa nji caktim definitiv, të paguejmë mot përmot nga 300.000 franga Kom. të Kufivet, apo të babet ky ratifikacion.

Unë kujtoj se nji njeri duhet të marrë responsabilitetin mbi vete dhe kësaj çeshtje të kufinit që na merziti t' i japim fund. Pra, z. Kryetar venje në votë e çeshtja të marrë fund.

Z. S. VUÇETRINI. Z. Kryetar ! Si dje ashtu edhe sot ndigjuem nga të ndershmit orator të kësaj Dhome disa fjalë t' idhë, ndigjuem edhe se po i këputen toka Shtetit t' onë, dhe përfunduene se ç' kemi të bajmë, se forca urdhron drjtësin. z. Kryetar ! Në qoftë se puna asht ashtu, unë nuk jam i mendjes për shkëputje tokash, për të lanë tokë, nuk tham kurr po, dhe ne mos paçim forcë mund të vdesin, se kur të vinë çeshtja për shkë-

BISEDIMET E DHOMES SË DEPUTETVET

putje, ma mirë tri dit me gajret se gjithmon me esgjet se nuk do të rrojmë 3000 vjet.

Neve që thamë po, thamë po, se proponimi i Qeveris asht për kembim ndrrim tokash në favor të Shtetit. Pra tjetër asht shkëputje tokash e tjetër asht shkembim tokash. Proponimi i Qeverisë kje me lanë nji copë tokë të thatë e me marrë nji tokë tjetër 4 hise ma teper.

Unë kësaj nuk i tham shkëputje tokash, dhe në qoftë se proponimi i Qeveris asht kështu unë në parim i jap autorizimin të bajnë marrëveshtjen të cilën të na e paraqesin në sesionin e aferm për aprovim. Pra, tue u mbështetun në shpjegimet e Qeveris, si dhe në raportin e Komisionit të përbashkët, jam i mendjes t'i japim autorizimin Qeveris të bajë marreveshjen për ndrrime në favor të Shtetit, dhe kur këjo marrëveshje të na paraqitet, po që se asht në favor të Shtetit e pranojmë, ne asht se jo e refyojmë.

Z. K. MJEDA. Z. Kryetar! Shk. e Tij Z. Xhafer Ypi që e kemi si villa Shkodran, se ka bëshkëpunue me Shkodren e e çmojmë, i dha randësin që meriton kësaj çështje. E vertëtë që Sh. Naumi ka nji randësi të madhe e edhe na e çmojmë, po se çë rendësi të madhe ka për krahin e Prefekturës së Shkodrës ajo pjesë historike,asnji prej Z. së Juej nuk mund t'a dijnë, dhe ketë e ka tregue me fakte e prova që kushto ka me muejtë me i kuptue. Ajo pjesë historike e krahut të Prefekturës së Shkodres ka dhanë me kuptue

kjartas se ç'randësi ka, dhe nuk asht nevojë të Ju ap zotnis s' Uej shpjegime, se ketë çështje e kan shpjegue Eletoret dhe Metinget që janë bâ. Edhe z. R. Fico ka marrë pjesë në keto metinge dhe e di mirë mjaft shka do me thanë Vermosh e Velopojë.

Z. S. BLLOSHMI: Mjeshter po na del z. e Jote...

Z. KOLË MJEDA: Mbasi kenkena mjeshtra, atëherë Zotnija e tij asht nxasë. Jamë kundershtar që të bahan këto, shkembime, po unë kam prap shpresë të plotë tu shpejtimtari i kur-doshem i Kombit t' onë, i cilli nuk ka me lanë kurr që të bjerrim të drejtat t' ona, dhe kam nji freski edhe përsigurimin që na dha Z. Ministri i P. të Jashme.

Z. IBRAHIM XHINDI: Z. Kryetar! Unë çuditem me Z. Kryetarin e Parlamentit i cili perpiqet t'i jepin nji send Z. Min. të Jashtëm që nuk e don. Z. Ministri i P. të Jashtme ker-kon nji autorizim në parim për të hyenë marreveshtje për nji shkembim në favor të Shtetit, edhe thotë që ketë marreveshje në sesjonin e aferm do t' a paraqesin në mbledhjen e dy Dhomave për aprovim, dhe ne qoftë se pranohet prej saj, atëherë merrë formen definitive. Zotnija e tij thotë t'a mbarojë çëshqjen definitivisht, Z. Ministër nuk e merr përsipër. Nuk kupto që ku do me dalë Z. e tij.

Z. JAKË KOÇI: Tue autorizuem

BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

Qeveritë si mbas kerkeset të paraqitun mbi perfundimin e kufinit shqiptaro-jugosllav, i lутем që më perfundimin e marrveshtjes të ketë para syshë nevojat e Shkodres, sidomos për ndrejtjen e Bunës, se ka kenë nji Shoqeni Jugosllave që e merr përsipër tue pagë 70%. Jugoslavija e 30%. Shqipnia. I falem nderit Z. Xhafer Ypit që përmendi Shkodren e Korçen. Korça asht gjyteti i Kulturës e i gjyqtetnimit Shkodra asht gjyteti kryesor i Male-sivet kreshnike, gjyteti i Oso Kukës që asht djegë mbi denga të barotit, gjyteti i kalas së Shkodrës me gjith historin e vet.

Z. XHAFER YPI: Z. Kryetar. Kur fola më perpara thashë se jam i idhur si unë, si i të gjithë populli se po i këputën dy copa Shtetit, edhe ato dy copa po i këputën me të varetë, e edhe këjo asht jashta deshirës së popullit, se distriktet që po perfaqesohen këtu, janë të gjith kundra. Sa do copa të vogla të janë për muajt, po e la vague, po edhe sikuer të mos ishin copa të mdha kemi ba kaqë mëtinge për Sh. Naum e për Vermosh. Unë voten t'ime nuk e dhash me konsciencen, por për interesë Shteti, dhe sikuer të mos kishe interesin e Shtetit para syesh. Edhe unë do të bashkoshe me përfaqesuesit e Shkodrës e të Korçës.

Z. FERID VOKOPOLA: Ne bisedimet që u banë, çështja u shpjegue fare mirë, unë do të jap shpjegime ve-

tëm mbi pikën, patriot e patriotizëm. Z. Kryetar! Në nji çështje kuer shikohet interes i përgjithshëm që asht shpirti i të drejtavet jetike t' Atëdhët atëherë interesat krahinare bijnë poshtë, se për Shqiptar ka vetëm Shqipni, dhe neve këtu jemi votue se nuk jemi deputetë e asnjë krahime, po përfaqesnesit e Kombit Shqiptar. Për me mprojta të drejtat e Shqipnis nuk do të vemi vetëm me imazgjiratione e sentimenje, se nga neve brezi ardhëshëm kerkon shpetim, dhe ata që kanë derguc kerkon udhëheqës. Kuer era e fort e rrëbtë e ndalon nji xhemijë të shkojnë nga juga, duhet nji kapidan i mirë me e drejtue atë xhemije me i ba ballë valave tembyt! Thohet patriotë e patrio izëm M. S. të genjehemi e mos të zgjasim kuvendin, se ne sullen që përbledhë ketë Asamble ka clemente e faktura që jo vetem që nga 1913, po edhe ma persara kanë vuejtë e kenë psue përkujtimi e kombit, për t'i arri ditës të kemi nji Atdhe indipendente, dhe na tuke qenë nga patriotët ma zogj duhet pakë t'i perulemi na pleqvet, tuke dijtur se ata i dinë ma mirë e i peshojnë ma bukur punët. Unë për veten t'ime, tuke qenë nga të vegjlit, tue pa ma të madhent se e pranojnë, tue shpresues se Qeverija do të sigurojnë interesat e Shtetit e jap ket autorizim. Po, dhe neve nuk duhet të disprohemi për gjera që bje fati e koha, se prap këto gjera mund të ndryshojnë, dhe neser pas tri ditësh, pas tre muejve mund të behet mirë.

BISEDI MET E DHOMES SE DEPUTETVET

Z. K. RADOVICKA: Z. Kryetar! Nuk do të flas mbi ketë çështje me qenë se të nd. përafolës e shkoqiten çësh-tjen se kam besin të plotë se Qeverija do të veprojë mbas interesavet të Shtetit. Unë do të them vetem qì këto bisedime të shtypen ma patë nga të tjerat në Fletoren Zyrtare, mbassi kë-jo çështje ka nji randësi të posaç-me.

Pranohet.

Z. KRYETARI : Tani po këndojmë proponimin e Qeveris i cili do të vehet në votim. Aj qì thotë po, d. m. th. e pranon e i jep autorizimin Qe-veris, aj qì thotë jo d. m. th. se nuk e pranon.

Këndohet proponimi i Qeveris si pason :

"Senati me Dhomen e Dëputetvet, të mbledhun së bashku, sot me 18. VII. 1925 për të biseduar mbi çësh-tjen e kufivet shqiptare-jugosllav pranon në parim, ad referendum, nji shke-mbim toke midis dy Shtetevet dhe autorizon Qeverin të hyejnë në marrë-veshtjet e duhura, konformisht me interesat e Shtetit, dhe të popullit shqip-tar.

Z. KRYETARI : Votimi behet no-minal.

Bahet thirrja emnore e Zz. Sena-torvet e të Deputetvet :

Abduraman Dibra, po; Anton Beça, po; Eqrem Vlora, po; Eshref Frasher, po; Halit Roji, po; Hafiz Xhemali (me leje); Ibrahim Xhindi, po; Isuf Ginali, po; Nafiz Dervishi, po; Pandeli Evan-gjeli, po; Petro Harito, po; Pjetër

Shan Deda, jo; Sali Vuçiterni, po; Sâ-mi Vrioni (mungon); Spiro Papa, po; Shefqet Verlaci (mungon), Shuk Sere-qi (me leje); Zia Toptani (mungon).

Abduraman Sali, po; Ahmet Has-topalli (me leje); Bahri Begolli (mu-nagon); Banush Hamdi (mungon); Be-xhet Frasher (mungon); Ceno Krye-ziu, po; Elmaz Xhafer, po; Ferid Vo-kopola, po; Fiqri Rusi, po; Hamid Muftiu (mungon); Hasan Biçaku, (mu-nagon) Hiqmet Delvina (mungon), Hy-sen Kuqi, po; Hysen Vrioni (me leje); Hysni Toska, po; Jak Koçi, po; Jashar Erebara, po; Javer Ursh'd, po; Gjorgj Çako, po; Kasem Radovicka, po; Kasem Seidin, po; Kol Mjeda, jo; Kolec Dedç, jo; Kostaq Kotta, po; Kristaq Kosturi (mungon); Kristo Floqi (mu-nagon); Lon Gjini (abstenon); Lon Llogori (mungon); Maliq Bushati, jo; Mihal Kaso, po; Millo Tutulan (mungon) Musid Libohova, po; Ndrek Kiçi, jo; Peter Poga po; Prenk Llesh Gjoni, jo; Qani Dishnica, po; Qa-zim Durmishi (mungon); Qemal Vrioni (mungon); Rauf Fico, po; Rexhep Mati (mungon); Sadik Shashka, po; Said Kalaja, jo; Salalydin Blloshmi, po; Seid Toptani, po; Dr. Simonidhi, po; Dr. Simon Popa, (mungon); Stavro Stavri (mungon); D.: Syreja Pojani (mungon); Shasivar Alltuni, po; Tef Gera, jo; Veis Sevrani, po; Vasil Bamiha, po; Dr. Voshori, po; Xhafer Ypi po; Xhelal Zogu, po; Xhemil Di-no, po; Zenel Mandiqi, jo.

Z. KRYETARI : Midis 52 zo, ërinjve

BQELIMET E DHOMES SE DEPOTTETVËR

prezent 40 janë po, 8 jo e nji abste- marrë autorizimin nga Asembleja.
non, d. m. th. se autorizohet Qeverija Duertrokitje e bravo.
të bajë marrëveshjen. Nga ky votim Mbylllet mbledhja n'oren 12 para
del ky përfundim që Qeverija paskëtaj dreke.
për me hye në marrëveshje duhet të

Sekretari
Spiro Papa

Kryetari
Eshref Frasherri